

## **UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E SALLËS NË QENDRËN LOKALE TË RESURSEVE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE**

- Të drejtën për përdorimin e sallës në Qendrën Lokale të Resurseve Horizonti i Ri - Ulqin (salla për takime, konferenca shtypi, fokus grupe dhe punëtori) e kanë të gjitha organizatat e shoqërisë civile dhe aktivistët tjerë të interesuar, të cilët dorëzojnë kërkesën për përdorimin e sallës brenda afatit të caktuar dhe kërkesa e të cilëve është në përputhje me kriteret e përcaktuara për dhënien e sallës.
- Kërkesa për përdorimin e sallës dorëzohet **së paku 10 ditë të para ngjarjes të planifikuar**. Kërkesa plotësohet **online** ose dorëzohet në adresën e e-mailit **ngohorizonti@t-com.me**
- Qendra e Resurseve është e detyruar të përgjigjet ndaj kërkesës për përdorimin e sallës jo më vonë se 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës.
- Qendra e Resurseve rezervon të drejtën për të refuzuar kërkesën sipas rregullave dhe kriterëve të veta për përdorimin e sallës.
- Qendra e Resurseve rezervon të drejtën për të kërkuar dokumentacion shtesë (dokument regjistrimi, statut, etj.).
- Përdorimi i kësaj salle nuk përfshin kompensim financiar nga përdoruesi.

### **Organizimi i aktivitetit**

- Salla e Qendrës së Resurseve është e kufizuar në numrin e pjesëmarrëseve që mund të pranojë, prandaj nuk rekomandojmë organizimin e ngjarjeve me më shumë se 15 persona.
- Salla jepet për një periudhë kohore të kufizuar me të drejtën për përdorimin e pajisjeve multimediale të caktuara. Përdoruesi ka përgjegjësi për çdo pajisje teknike shtesë.
- Aktiviteti mund të organizohet gjatë ditëve të punës (duke filluar nga **e hëna në të premte**) nga ora **10:00h - 15:00h**.

### **Pas aktivitetit**

- Përdoruesi është i detyruar që hapësirën e cila i është dhënë në përdorim, ta kthejë në gjendjen e saj fillestare.
- Përdoruesi është i detyruar të mbulojë shpenzimet në raste dëmtimi të çdo pajisjeje ose materialit tjetër nga organizatori apo pjesëmarrësit e aktivitetit.